



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Pronë dhe Kadastër, mbajtur më 01.08.2022,  
duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e komitetit: Ermal Osmani - VV, Sami Salihu - LDK, Agim Kuleta - LB, Endrit Gashi - AAK, Rinë Zhitia - eksperte e jashtme.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Arton Brahim**i, përfaqësues nga Sektori për punë të Kuvendit.

Për mbledhje propozon këtë

### REND TË DITËS:

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Pronë dhe Kadastër;
2. Të ndryshme.

**Arton Brahim**i përshëndeti të pranishmit, duke thënë se sot kemi mbledhjen inauguruese të Komitetit për Pronë dhe Kadastër. Këto komitete janë të formuara në bazë të Udhëzimit administrativ 05/2020, të datës 21.12.2020 dhe Vendimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës, më 10.05.2022, nr. 01-020/02-103516/22. Sot si pikë e rendit të ditës është zgjedhja e kryesuesit të Komitetit, andaj do ta bëjmë propozimin e njërit prej anëtarëve për kryesues të Komitetit dhe do ta votojmë.

**Rinë Zhitia** tha për kryesues të këtij komiteti propozoi anëtarin **Ermal Osmanin**.

*Anëtarët e Komitetit njëzëri e votuan z. Ermal Osmani, për kryesues të Komitetit për Pronë dhe Kadastër.*

**Ermal Osmani** i falënderoi anëtarët e këtij komiteti për besimin e dhënë.

Ai tha se të gjithë së bashku do të koordinohemi për mbledhjet e radhës.

**Arton Brahim**i njoftoi anëtarët e Komitetit se sipas Udhëzimit administrativ parashihen 6 mbledhje brenda vitit, të cilat janë me pagesë.

Faqe 1 nga 3

Ai bëri të ditur se në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e udhëheq anëtari më i moshuar. Po ashtu, sipas këtij udhëzimi Komiteti duhet ta paraqesë raportin vjetor të punës pranë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive përkatëse, ju si komitet mund ta hartoni edhe një plan të punës, në bazë të të cilit mund të punoni në mbledhjet e radhës.

**Agim Kuleta** tha se materialet të cilat shkojnë në Kuvend nga këto dy drejtori, duhet të shqyrtohen paraprakisht nga ne në Komitet. Ne jemi këshilldhënës për këto drejtori, dhe mbledhjet duhet t'i planifikojmë sipas agjendë s së drejtorëve. Ai tregon se gjatë mandatit të tij sa ishte kryesues i Kuvendit, janë mbajtur shumë pak mbledhjet e këtyre komiteteve.

**Ermal Osmani** tha se ne si komitet do të jemi të bashkëpunues dhe do të ndimojmë shumë, pasi që në shumicën e mbledhjeve të Kuvendit kemi pika të rendit të ditës që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Pronës.

**Agim Kuleta** tha se mbledhjet e këtij komiteti do të ishte mirë të mbahen para mbledhjes së KPF-së, për shkak të shqyrtimit nga ana jonë si komitet, pastaj t'i dërgojmë në KPF dhe në Kuvend.

**Sami Salihu** tha se ne po kemi probleme, për shkak se disa nga pikat e rendit të ditës të mbledhjes së Kuvendit, po futen aty për aty në rend të ditës. Sipas kësaj, ne si Komitet mund të dalim ndoshta pak keq për shkak të mos shqyrtimit të atyre pikave.

**Agim Kuleta** tha se rendi do të ishte mirë të ishte ashtu, pra Komiteti, KPF-ja dhe Kuvendi. Po nuk është se do të zbatohen gjithmonë këto procedura, pasi që ka momente që disa nga pikat vijnë në momente të fundit para fillimit të mbledhjeve. Unë këtë nuk e shoh shumë tragjike, pasi që lënda të jetë sa më e kompletuar është më mirë, por ne jemi më shumë politik dhe do të diskutojmë politikisht, në drejtim të politikave të qytetit dhe mirëqenies së qytetarëve. Pra ato pika të cilat kalojnë në Kuvend, mund të ndodhë të kenë edhe mungesa të dokumenteve, por është Ministria që i kontrollon ato, dhe në qoftë se mungon diçka ose i kthen negative, ose kërkon që të kompletohet lënda. Pra po fokusohemi shumë në pjesë procedurale administrative dhe po e lëmë anash pjesën përmbajtësore.

**Ermal Osmani** te pika tjetër "Të ndryshme", tha se në ueb-faqen e Komunes, janë shënimet rreth punëve të këtyre dy drejtorive. Por ndoshta kishte me qenë më mirë që në mbledhjet e ardhshme të vijnë vetë drejtorët dhe të na njoftojnë për punët dhe problematikat e këtyre dy drejtorive.

**Agim Kuleta** theksoi se do të ishte mirë të takohemi me drejtorët dhe ta shohim edhe planin e tyre të punës, qoftë ai javor, mujor apo vjetor. Përndryshe, mendoj si këshill për mbledhje të këtij komiteti nuk është në pyetje vetëm koha se sa zgjat takimi, pra të mos merret për bazë ajo se kemi thirrë mbledhje dhe ta zgjasim sa më shumë, aq sa ka nevojë aq edhe duhet ta zgjasim.

**Ermal Osmani** tha se unë si kryesues do të përpiqem ta zbatoj edhe rregulloren ashtu si është, se kujt t'i jap fjalën apo të merremi vesh edhe në mënyrë interaktive.

**Sami Salihu** tha se do të ishte mirë ta formojmë ndonjë grup, në mënyrë që herë pas here të kontaktojmë edhe përmes rrjeteve sociale, dhe mos të mbetet vetëm kur të takohemi për mbledhje.

Ermal Osmani tha se do t'i shohim dhe t'i shfrytëzojmë të gjitha mundësitë e komunikimit në të mirë të këtij komiteti.

*Mbledhja përfundoi në orën 16:30*

Procesmbajtësi  
Arton Brahim

Kryesuesi i mbledhjes së Komitetit  
Ermal Osmani



Faqe3nga3